UDHËZIM
Nr. 186, datë, 28.9.2022

MBI PROCEDURAT PËR SIGURIMIN E ASISTENCËS NË TRANZIT, ME QËLLIM KTHIMIN NË RRUGË AJRORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 123, pika 2, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me qëllim harmonizimin e procedurave për ofrimin e asistencës në rastet e tranzitit për qëllime të largim/dëbimit në rrugë ajrore,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i masave për ndihmën midis autoriteteve kompetente në aeroportet e shteteve të tranzitit, në lidhje me largim/dëbimet e pashoqëruara dhe të shoqëruara në rrugë ajrore.

2. Përkufizime:

a) "Shtetas i një vendi të tretë" është çdo person që nuk është shtetas i shteteve (palë) kontraktuese.

b) "Shtet kontraktues kërkues" është shteti (palë) kontraktues, që zbaton një vendim kthimi, në lidhje me një shtetas të palëve kontraktuese ose të një shtetasi të vendit të tretë.

c) "Shtet i tranzitit" është shteti ku ndodhet aeroporti i tranzitit nëpërmjet të cilit do të kryhet tranziti.

d) "Shoqërues" është personeli i sigurisë përgjegjës për shoqërimin e shtetasit të vendit të tretë, përfshirë personat përgjegjës për kujdesin mjekësor dhe përkthyesit.

e) "Tranzit ajror" është kalimi i shtetasit të vendit të tretë dhe sipas nevojës, kalimi i shoqëruesve përmes zonës së aeroportit të shtetit të kërkuar për qëllimet e largim/dëbimit në rrugë ajrore.

3. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që dëshiron të kthejë në rrugë ajrore një shtetas të një vendi të tretë, shqyrton mundësinë e përdorimit të një fluturimi direkt drejt shtetit të destinacionit.

4. Kur autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dëshiron të kthejë një shtetas të një vendi të tretë, por për arsye të rrethanave praktike të arsyeshme nuk mund të përdorë një fluturim direkt drejt vendit të destinacionit, ai mund të kërkojë tranzitin ajror nëpërmjet një tjetër shteti (palë) kontraktues. Nuk bëhet kërkesë për tranzit ajror në parim, nëse masa e largimit kërkon ndryshim të aeroportit në territorin e shtetit kontraktues të kërkuar.

5. Shteti kontraktues i kërkuar mund të refuzojë tranzitin ajror, nëse:

a) shtetas i një vendi të tretë akuzohet për vepra penale ose kërkohet për kryerjen e një dënimi, sipas legjislacionit të brendshëm të shtetit kontraktues të kërkuar;

b) tranziti nëpër shtete të tjera ose pranimi nga vendi i destinacionit nuk është i realizueshëm;

c) masa e largimit kërkon ndryshimin e aeroportit në territorin e shtetit kontraktues të kërkuar;

d) ndihma e kërkuar nuk mund të jepet në një moment të caktuar për arsye praktike;

e) shtetasi i vendit të tretë mund të jetë kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, për sigurinë kombëtare ose mund të cenojë marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit kontraktues.

6. Në rastin e paragrafit 5, germa "d", shteti kontraktues i kërkuar duhet të informojë brenda 24 orëve autoritetin kompetent të shtetit kontraktues kërkues për një datë sa më afër datës së kërkuar në fillim, në të cilën mund të realizohet tranziti ajror për sa kohë që janë plotësuar kushtet e tjera.

7. Autorizimet për tranzit ajror të cilat janë lëshuar tashmë, mund të revokohen nga shteti kontraktues i kërkuar, nëse pas autorizimit shfaqen rrethana sipas kuptimit të paragrafit 5, të cilat justifikojnë refuzimin e tranzitit.

8. Shteti kontraktues i kërkuar njofton menjëherë shtetin kontraktues kërkues për refuzimin ose revokimin e autorizimit për tranzitin ajror, në zbatim të paragrafit 5 ose 7, ose për çdo arsye tjetër pse tranziti nuk është i mundur duke dhënë një shpjegim për arsyet përkatëse.

9. Kërkesa për tranzit ajror të shoqëruar ose të pashoqëruar dhe për masat shoqëruese të ndihmës në zbatim të paragrafëve 15, 16 dhe 17, bëhet me shkrim nga shteti kontraktues kërkues. Ajo dërgohet në shtetin kontraktues të kërkuar sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast, jo më vonë se dy ditë përpara tranzitit. Ky afat kohor mund të mos respektohet në raste veçanërisht urgjente dhe të justifikuara.

10. Shteti kontraktues i kërkuar informon shtetin kontraktues kërkues për vendimin e marrë prej tij brenda dy ditësh. Ky afat kohor mund të shtyhet në raste të justifikuara, për një maksimum prej 48 orësh.

Tranziti ajror nuk fillon pa miratimin e shtetit kontraktues të kërkuar, në rastet:

a) kur asnjë shtet kontraktues i kërkuar nuk përgjigjet brenda afateve sa më sipër, operacionet e tranzitit mund të fillojnë me anë të një njoftimi nga shteti kontraktues kërkues;

b) mund të parashikohet, në bazë të marrëveshjeve ose masave dypalëshe ose shumëpalëshe, që operacionet e tranzitit të fillojnë me anë të një njoftimi nga shteti kontraktues kërkues.

11. Për të kërkuar dhe autorizuar tranzitin ajror, autoriteti i shtetit kontraktues kërkues i përcjell autoritetit të shtetit kontraktues të kërkuar informacionin e duhur nëpërmjet postës elektronike zyrtare.

12. Shteti kontraktues kërkues i jep shtetit kontraktues të kërkuar detajet e çdo kërkesë për tranzit.

13. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve është përgjegjës për trajtimin e kërkesave për tranzit ajror.

14. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve cakton pikat e kontaktit për aeroportin/et përkatëse të tranzitit, të cilat mund të kontaktohen gjatë gjithë operacioneve të tranzitit.

15. Shteti kontraktues kërkues merr masat e duhura për të siguruar që operacioni i tranzitit të kryhet në kohën më të shkurtër të mundshme. Operacioni i tranzitit kryhet maksimalisht brenda 24 orëve.

16. Shteti kontraktues i kërkuar, në bazë të konsultimeve të ndërsjella me shtetin kontraktues kërkues, brenda kufijve të mjeteve në dispozicion dhe në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, ofron të gjitha masat ndihmëse të nevojshme që nga ulja dhe hapja e dyerve të mjeteve të fluturimit, derisa të sigurohet që shtetasi i vendit të tretë të jetë larguar. Konsultimet e ndërsjella nuk janë të nevojshme, në rastet e përmendura në paragrafin 17, germa "b".

17. Konsultimet e ndërsjella kanë të bëjnë me masat e mëposhtme të ndihmës, në veçanti:

a) marrja e shtetasit të vendit të tretë në mjetin e fluturimit dhe shoqërimi i tij brenda mjediseve të aeroportit të tranzitit, në veçanti drejt fluturimit të tij lidhës;

b) ofrimi i kujdesit mjekësor emergjent për shtetasin e vendit të tretë dhe, nëse është nevojshme, për shoqëruesin e tij;

c) ofrimi i ushqimit për shtetasin e vendit të tretë dhe, nëse është e nevojshme, për shoqëruesin e tij;

d) marrja, ruajtja dhe dërgimi i dokumenteve të udhëtimit, veçanërisht në rastet e largimeve të pashoqëruara;

e) në rastet e tranzitit të pashoqëruar, informimi i shtetit kërkues për vendin dhe kohën e nisjes së shtetasit të vendit të tretë nga territori i shtetit anëtar në fjalë;

f) informimi i shtetit kërkues nëse kanë ndodhur incidente serioze gjatë tranzitit të shtetasit të vendit të tretë.

18. Në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, pala e kërkuar mund të:

a) vendosë dhe akomodojë shtetasit e një vendi të tretë në një objekt të sigurt;

b) përdorë mjete legjitime për të parandaluar ose për t'i dhënë fund çdo përpjekjeje të shtetasit të vendit të tretë për të kundërshtuar tranzitin.

19. Në rastet kur përfundimi i operacioneve të tranzitit nuk mund të garantohet pavarësisht ndihmës së dhënë në përputhje me paragrafët 16 dhe 17, pala e kërkuar, sipas kërkesës nga/dhe në konsultim me palën kërkuese, mund të marrë të gjithë masat ndihmëse të nevojshme për të vazhduar operacionin e tranzitit. Në këto raste, afati kohor i përmendur në paragrafin 15, mund të shtyhet deri në një maksimum prej 48 orësh.

20. Autoritetet kompetente të palës së kërkuar, përgjegjëse për masën, vendosin për natyrën dhe masën e ndihmës së ofruar ,sipas paragrafëve 17, 18 dhe 19.

21. Kostot e shërbimeve të ofruara, sipas paragrafit 17, germat "b" dhe "c", mbulohen nga pala kërkuese.

22. Palët e interesuara japin informacionin e nevojshëm për kriteret e matjes së kostove.

23. Pala kërkuese merr përsipër të ripranojë menjëherë shtetasit e një vendi të tretë, nëse:

a) autorizimi për tranzitin ajror është refuzuar apo revokuar;

b) shtetasi i vendit të tretë ka hyrë në shtetin anëtar të kërkuar pa autorizim gjatë tranzitit;

c) largimi i shtetasit të vendit të tretë drejt një tjetër vendi tranziti ose drejt vendit të destinacionit, ose hipja në bordin e fluturimit lidhës, kanë qenë të pasuksesshme; ose

d) tranziti ajror është i pamundur për një arsye tjetër.

24. Pala e kërkuar ndihmon në ripranimin e shtetasit të një vendi të tretë në shtetin e palës kërkuese, në rastet e përmendura në paragrafin 23. Pala kërkuese mbulon shpenzimet për kthimin shtetasit të një vendi të tretë.

25. Gjatë kryerjes së operacionit të tranzitit, kompetencat e shoqëruesve zbatohen vetëm për vetëmbrojtje. Përveç kësaj, në mungesë të zyrtarëve të zbatimit të ligjit nga shteti i tranzitit ose me qëllim të mbështetjes së zyrtarëve të zbatimit të ligjit, shoqëruesit mund të ndërmarrin veprime të arsyeshme dhe proporcionale në përgjigje të një rreziku të menjëhershëm dhe serioz, në mënyrë që të parandalojnë që shtetasi i një vendi të tretë të arratiset, të shkaktojë dëmtim ndaj vetes ose ndaj një pale të tretë ose dëmtim të pronës. Në të gjitha rrethanat, shoqëruesit duhet të veprojnë në përputhje me legjislacionin e palës së kërkuar.

26. Shoqëruesit nuk mbajnë armë gjatë tranzitit ajror dhe mbajnë veshur rroba civile. Ata paraqesin mjetet e duhura të identifikimit, përfshirë autorizimin e tranzitit të dhënë nga shteti i tranzitit ose, kur është e zbatueshme, njoftimin e përmendur në paragrafin 8, me kërkesën e shtetit të kërkuar.

27. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

28. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi